



489/5
29.09.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORE

Nr.406 Akti

Datë 18.01.2016

Nr.183 Vendimi

Datë 18.02.2016

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:
GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 18.02.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.406 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: Mirela Toska, e bija e Spiros, banuese në lagjen "28 Nëntori", Berat, (në mungesë).

I PADITUR: 1-Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.3001/1 prot, date 09.02.2016 nga Silvana Sallo .

2-Drejtorja Rajonale Tatimore Berat, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.489/2 prot, datë 02.02.2016 nga Silvana Sallo.

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë, (në mungesë).

OBJEKTI: 1-Shfuqizimin e njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore me nr.2034/17 prot, datë 13.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat si dhe të vendimit me nr.27715/3 prot, datë 14.12.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17,18 e 42 të Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ, neni 1 i Protokollit nr.1 i KEDNJ, K.Pr.Civile, Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", ligji K.Pr.Administrative, ligji nr.10279, date 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative", ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, V.K.M nr.781, datë 14.11.2007 (të ndryshuar), dhe V.K.M nr.1286, date 13.12.2009.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, pala paditëse Mirela Toska nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi ishte në

igesë por referuar kërkesë padisë ka kërkuar nga gjykata pranimin e kësaj padisë, dëgjoi palët e paditura Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, përfaqësuesen e tyre Silvana Durrës, e cila kërkoj nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë, pala pjesëmarrëse në procesin Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua dhe nuk ka marrë qytetuesit konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të gjykatës gjykate, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e dërguar qytetuesit që ka pasur për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V È R E N

Se pala paditëse Mirela Toska i është drejtuar Gjykatës së Rrethit të Parë Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të cesë padisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit 9/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe imin e mosmarrëveshjeve administrative" çështja objekt gjykimi hyn në dksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të ratës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 7 dhe 12 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë.

Rrethanat e faktit:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësj Mirela Toska është e istruar si subjekt fizik i pajisur me nr. L43417004M NUIS, me adresë të vitetit në lagjen, "Jani Vruho", Berat, me objekt veprimtarie "Tregëti me icë e mishit dhe e produkteve me bazë mishi".

Rezulton se në datë 07.09.2015 nga inspektorët e palës së paditur Gjytoria Rajonale e Tatimeve Berat është ushtruar kontroll pranë palës së litëse ku është mbajtur akti i konstatimit me nr.0474448 serie datë 04.2015 ku është konstatuar se "subjekti është i regjistruar në Q.K.R dhe se c është i pajisur me kasë fiskale".

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat është nxjerre ftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.2034/17 prot datë 13.10.2015 paditëse Mirela Toska subjekt fizik i pajisur me nr.L43417004M ku është shkionuar me gjobë në masën 50.000(pesëdhjetë mijë) lekë, nuk është i pajisur me kasë fiskale, veprimi i cili vjen në kundërshtim me nenin 122 pika 1 të art. 17 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008" *Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*".

Paditësja pasi ka marrë dijeni për njoftim vlerësimi për detyrimet
more me nr.2034/17 datë 13.10.2015 ka ushtruar ankim administrative
aj tij në datë 16.09.2015 pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor në Drejtorinë e
gjithshme Tatimeve Tiranë.

Nga Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë me shkresën me nr.27715/3 prot
ë 14.12.2015 është vendosur "lënia në fuqi i aktit administrative njoftim
rësimi për detyrimet tatimore me nr.2037/17 datë 13.10.2015 i nxjerrë nga
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat".

Paditësja Mirela Toska duke mos qenë dakort me njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.2034/17 datë 13.10.2015 i lëshuar nga pala paditur, i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;

Së pari; paditesja Mirela Toska ushtron aktivitet privat me objekt "Tregti e pakice mishi dhe artikuj te ndryshem".

Me njoftim vlerësimin nr.2034/17 prot, date 13.10.2015 D.R.T. Berat paditësja është njoftuar se ajo detyrohet të paguaje gjobe ne shumen 50.000 esëdhjetë mijë) lekë.

Paditësja Mirela Toska ka paraqitur ankim në Drejtorine e Apelitit timor Tirane dhe me vendimin nr.27715/3 prot, date 05.10.2015 ka ndosur "Lenien ne fuqi te aktit objekt ankimi administrativ, Njoftim Vleresimit per Detyrimet Tatimore Cjobe, nr.2034/17 prot, date 13.10.2015 gjobe ne shumen 50.000 leke per mospajisje me kase fiskale, nxjerre nga Drejtoria tjonale Tatimore Berat dhe rrezimin e ankimit".

Në datë 13.05.2015 shtetasi Saimir Toska, bashkëshorti i paditeses ka kryer aplikimin per mbylljen e aktivitetit privat me te njejtin objekt si me siper te ka dorezuar kassen fiskale prane CKV-NOKI ALBANIA me qellim qe te kryshohej nipti i paisjes fiskale, pasi ne te njejtin biznes do ushtronte aktivitet paditesja.

Me qellim qe te kryheshin proceduarat perkatese paditesja eshte paraqitur prane DRT Berat dhe ka kerkuar dëftesat-tatimore, te cilat jane per vendesim i kases fiskale.

Së dyti; në V.K.M nr.1286, date 23.12.2009 ne piken 15 te saj rashikohet se " Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra o ofrojne sherbime ne mjedise, apo njesi te perhershme te hapura per publikun, instalojne pajisje fiskale dhe leshojne kupone tatimore per cdo transakcion".

Ne V.K.M nr.781, date 14.11.2007 (e ndryshuar) pika 8.2 eshte percaktuar procedura qe duhet te ndiqet ne rastet e transferimit te pajisjes fiskale brenda te njejtit subjekt dhe ne piken 8.3 eshte percaktuar procedura duhet te ndiqet ne rastet e perfundimit te veprimtarise se biznesit dhe regjistrimit i paisjes fiskale.

Në pikën 8.2 Transferimi i pajisjes fiskale brenda te njejtit subjekt ku rashikohet se "Transferimi do te behet pas miratimit me shkrim nga ministrata tatimore dhe kjo procedure kryhet nga tekniku i autorizuar. Kryshimi i adreses eshte i mundur te behet vetem pasi te jete kryer raporti timor ditor me pajisje fiskale te hapura. Keto ndryshime do te pasqyrohen ne nen e numrit te ndryshimeve te adreses, si dhe ne raportin tatimor ditor sardhes. Te dhenat e ndryshuara qe do te dergohen ne Drejtorine e gjithshme te Tatimeve permes rrjetit te unikimit GPRS jane si me poshte vijon: Identifikimit te tatim paguesit:

Numri dhe adresa e re;

Numri i identifikimit te pajisjes fiskale;

Numri i identifikimit te transmetuesit te te dhenave (IMEI);

Numri i identifikimit te kartes SIM (IMS);

7) kodi i teknikut te autorizuar qe po kryen proceduren;
numeratori ndryshimit te adreses.

Pas dergimit te ketyre te dhenave, pajisja fiskale printon nje kupon me
qe te dhena dhe ku tekniku i autorizuar ploteson librin e mirembajtjes se
tjes fiskale dhe ia bashkengjit kuponin e printuar ketij libri.

Së treti; në rastin konkret paditesja Mirela Toska ka kryer te gjitha
cedurat per ndryshimin e nipit dhe emrit ne pajisjen fiskale dhe eshte
isur nga D.R.T.Berat me deftesat tatimore, te cilat jane për zëvendesim te
es fiskale për periudhen qe me kasen fiskale ishin duke kryer veprimet per
ryshimet perkatese nga shoqeria CKV-NOKI ALBANIA, te caktuar nga shteti
menyre te detyrueshme per subjektet dhe se shteti po kontrollon shitjen e
save, ndryshimin e tyre duke i detyruar subjektet te bejne keto veprime me
subjekte qe jane te lidhura me shtetin.

Kasa fiskale ka qenë në emër të bashkëshortit të paditëses bashkeshortit
e ku më pas u kalua në emër të paditëses disa dite pas vendosjes se gjobes
i pala e paditur, megjithese paditësja kishte që në muajin Tetor te vitit 2014
kishte kerkuar këtë ndryshim pranë palës së paditur dhe shoqërisë që bënë
endësimin e kasës fiskale

Për sa me sipër paditësi Mirela Toska kërkoi nga gjykata pranimin e
kesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

**Palët e paditura Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Drejtoria e
gjithshme e Tatimeve Tiranë me anë të përfaqësueses së tyre Silvana
lo kane kerkuar rrezimin e kerkese-padise duke prapësuar ne gjykim**

Së pari; Drejtoria Rajonale Tatimore Berat dhe Drejtoria e Apelim
imor Tirane jane pale te padituara ne ceshtjen me objekt "*Shfuqizimin e
eve administrative..*" me padites subjekti fizik Mirela Toska me nr.Nipt
417004M dhe lagjen "Jani Vruho", Berat.

Subjekti Mirela Toska me nr. Nipt L43417004M, eshte regjistruar ne
gtorine Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Tregeti me pakice e
shit dhe e produkteve me baze mishi", me adrese te aktivitetit ne lagjen,
"Jani Vruho", Berat.

Me ane te Njoftim Vlersimit nr. 2034/17 date 13.10.2015 derguar nga
D.T.Berat, subjektit i eshte komunikuar penaliteti ne vlere 50.000
(sëdhjetë mijë) leke per mos paisje me kase fiskale, bazuar ne ligjin nr.9920
e 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i
shuar, neni 122 pika 1 germa a,i.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrative per detyrimet tatimore
ftim Vleërsimin me nr.2034/17 date 13.10.2015, ne Drejtorine e Apelim
imor Tirane, e cila me vendimin nr.27715/3 prot datë 14.12.2015 (prot me
T Berat me nr.6797 date 17.12.2015) ka vendosur "*Lënien në fuqi të aktit
ministrative Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore nr. 2034/17 date
10.2015 nxjerre nga DRT Berat*".

Së dyti; vlerësimi tatimor është rrjedhojë e penalizimit, si rezultat i rrollit të ushtruar në subjektin Mirela Toska nga inspektorët e Hetimit në Rajonin Jugor (Sektori i Zbatimit), të cilët kanë mbajtur akt-konstatim nr. serial 0474448, datë 23.04.2015, ku u konstatua se subjekti nuk është i ushtruar me pajisje fiskale. Nga kontrolli i ushtruar në subjektin Mirela Toska është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0474448, datë 23.04.2015, në të nder të tjera shprehet se *"në momentin e kontrollit subjekti nuk është i ushtruar me pajisje fiskale, mbahet ky akt-konstatim për ndjekje të metejshme nga tani tatimor"*.

Akti i konstatimit është i firmosur nga inspektorët tatimor të Hetimit në Rajonin Jugor (Sektori i Zbatimit) të cilët kanë kryer kontrollin në akt si dhe është firmosur edhe nga vet Mirela Toska.

Për procedime të metejshme, nisur prej faktit që subjekti është nën inishtim të drejtorisë tone, Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajonin Jugor (Sektori i Zbatimit) me shkresën nr.482 prot, datë 04.05.2015 protokolluar me nr.2034, datë 06.05.2015 me lende "Dërgim akt-konstatime, Proces i Gjykatës" ka dërguar nder të tjera dhe aktin e konstatimit me nr.serial 4448 datë 23.04.2015, për procedim të metejshëm nga ana e drejtorisë

Së treti; me shkresën memo, nr.2034/9 prot, datë 28.05.2015, me lende *kese për miratim vlerësimi tatimor*, inspektori tatimor i është drejtuar Drejtorisë Rajonale për miratimin e vlerësimit tatimor bazuar në dokumentacionet të kësaj lloji nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajonin Jugor (Sektori i Zbatimit).

Në memo shprehet me saktësisht se sipas akt-konstatimit me nr.serial 4448 datë 23.04.2015 në Berat dhe ku është konstatuar se subjekti Mirela Toska me nipt L4341 7004M adresë lagja Jani Vruho me veprimtari ekonomike "Tregtaria e Mishi" i përfaqësuar nga znj Mirela Toska; subjekti i mesipër është i ushtruar në QKR me certifikatë me nr serial SN 252618- 10- 14 0; subjekti është afishuar cmimet e produkteve që tregton; në momentin e kontrollit subjekti nuk është i pajisur me pajisje fiskale; në bazë të ligjit nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar nën 122 pika ma a,i nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të kontrollit denohet me gjobë në shumën 50.000 leke; në momentin e rrollit në punë u gjetë Mirela Toska datë 30.05.1972.

Mirela Toska reulton se është e regjistruar si tatimpagues ku deklaronte paguan kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore .

Referuar Akt Konstatimit me nr.serie 0474448 datë 23.04.2015 nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajonin Jugor Sektori i Zbatimit, subjekti Mirela Toska në bazë të ligjit nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Neni 122 pika 1. germa a,i, nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit denohet me gjobë në shumën 50.000

dhe ku në vijim të procedurës është nxjerre akti administrativ, Njoftimi Nr. 2034/17 datë 13.10.2015, që ka penalizuar paditësen me gjobë në shumën 50 000 leke dhe se gjoba e nxjerre nga ky njoftim-vlerësim në vlerën 50 000 leke, për mos instalim të pajisjes fiskale, është i bazuar në ligjin nr.9920,

date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, nenin 122 pika 1 germa a-i.

Së katërti; në akt konstatim nder te tjera shprehet se "Ne momentin e kontrollit subjekti nuk eshte i pajisur me paisje fiskale instalimi dhe funksionimi kesaj paisje percaktohet ne menyre te detajura ne VKM nr.781 date 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te paisjeve fiskale , sistemit te integruar te kompjuterizuar per transmetimet periodike, automatike, te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit, per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per paisjen, me autorizim, shoqerive te autorizuar per ofrimin e paisjeve fiskale"

Detyrimi per te instaluar dhe perdorur pajisjet fiskale, percaktohet ne gjin Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperis" i ndryshuar, neni 55 "Detyrimi per perdorimin e paisjeve fiskale" si te në VKM me nr.781 date 14.11.2007 pika 1, detyrimi i tatim paguesit për instalimin e paisjeve fiskale ku parashikohet se "I-Detyrimi per instalimin e paisjeve fiskale Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te shërbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, ose ne sektoret e tjante te percaktuar ne kete vendim apo ne udhezimet e Ministrise se financave, jane te detyruar teperdorin pajisje apo sisteme fiskale, per jistrimin e qarkullimit, duke leshuar kuponin tatimor."

Udhezimit Nr.24 date 02.09.2008 ne zbatim te ligjit.Kreu VI,pika 55 ku parashikohet se " Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar te tatimit mbi fitimin dhe personal e tatueshem, subjekte te takses vendore te biznesin e vogel dhe tatimit mbi te ardhurat, jane te detyruar te pajisen, teperdorin dhe mirembajnepajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit Nr.781, date 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te paisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transmetimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per paisjen me autorizim te shoqerive te autorizuar per ofrimin e paisjeve fiskale" dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij.."

Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.781, date 14.11.2007 ne lidhje me jistrimin e qarkullimit, ku parashikohet se "Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve te mallrave, qe shesin mallra apo ofrojne shërbime ne mjedise, apo njesi te shërbimeve te hapura me publikun, instalojne paisje fiskale dhe leshojne kupone tatimor per cdo transakcion".

Per sa eshte parashikuar me larte pala paditese ka ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne kundërshtim me percaktimet e ligjit me nr.9920/2008 dhe akteve nen ligjore ne fuqi duke inosperdorur kasen fiskale konforme me rregullave te perdorimit ne kryerjen e veprimeve tregetare.

Për sa më sipër palët e paditura Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Prokuroria e Përgjithshme e Tiranës, nëpërmjet përfaqësueses së tyre e kërkojnë nga gjykata rrezimin e kërkesë padisë si e pabazuar në ligj dhe në

Pala e pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë ne gjykim ka kerkuar rrezimin e kerkese-padise me arsyetimin e pales se paditur.

Gjykata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditësja Mirela Toska është e pabazuar në ligj e prova dhe si e tillë do të rrëzohet.

Arsyetimi ligjor:

Në nenin 7, pikë 1 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për; mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të detyrimeve të organit publik.

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Të drejtën e padisë e ka: çdo subjekt, që pretendon se i është cënruar një e drejtë apo një interes i vëllimshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Ne nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Padia ngrihet; për shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ.

Rezulton se pala paditëse Mirela Toska nuk ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nxjerrë nga pala e paditur DRT Berat lene ne fuqi nga Drejtoria e Tatimit Tatimor, pasi ky akt administrativ eshte nxjerre ne zbatim te ligjit.

shtja objekt gjykimi rregullohet nga nr.9920 datë 19.05.2008, "Për procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar).

nenin 54 të ligjit parashikohet se "1. Kuponi tatimor është dokumenti i marrë me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat elektronik.

Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë çfarëdheqat faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën. Në gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të ofrojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shërbimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

nenin 55 te ligjit parashikohet se '1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e

mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

2. Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me licencë të hoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së licencës për këto hoqëri.

Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.

eni 122/1/g i ligjit parashikon kundravajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave dhe konkretisht :
timpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të
rkullimit:

herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose
temeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000
sëdhjetë mijë) lekë; Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që
ësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose
emit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për
dosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të
cullimit;

ëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes "i", më sipër, konstatohet se
mpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e
save me para në dorë, ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me
iskim të të gjithë sasisë së mallit;

lo konstatim i mëposhtëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të
torimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç
shikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën
trashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzim penal për
paguesin;

ton se paditesja në momentin e kontrollit të ushtruar nga pala e paditur
a pasur kasën fiskale të instaluar dhe për këtë arsye ka shkelur nenin
/g të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 'Për procedurën tatimore në RSH'.

simi i pales paditese se ajo ka bere kerkese qe prej vitit 2014 per
rim te kases se biznesit te bashkeshortit te saj Saimir Toska ne biznesin
firela Toska dhe ishte detyrim i pales se paditur qe te bente transferimin
enave te kases fiskale ne emer te saj eshte i pabazuar ne ligj dhe ne

1 nr. 781, datë 14.11.2007 të ndryshuar parashikohet në pikën 8.2 të tij
rimi i pajisjes fiskale brenda të njëjtit subjekt dhe konkretisht

Transferimi do të bëhet pas miratimit me shkrim nga administrata tatimore dhe kjo procedure kryhet nga tekniku i autorizuar. Ndryshimi i adresës është i mundur të bëhet vetëm pasi të jetë kryer raporti tatimor i litor me pajisje fiskale të hapura. Këto ndryshime do të pasqyrohen në ritjen e numrit të ndryshimeve të adresës, si dhe në raportin tatimor i litor pasardhës. Të dhënat e ndryshuara që do të dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit të komunikimit GPRS janë si në poshtë vijon:

- a) numri identifikimit të tatimpaguesit;
- b) emri dhe adresa e re;
- c) numri i identifikimit të pajisjes fiskale;
- d) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);
- e) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);
- f) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën;
- g) numërtori i ndryshimit të adresës.

Pas dërgimit të këtyre të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto të dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe bashkëngjijtë kuponin e printuar këtij libri.

Nëse nuk provohet se pala paditese ka bere kerkese per transferim kase brenda te 3 ditëve të jetit subjekt dhe kjo kerkese per transferim te jete miratuar me shkrim nga administrata tatimore

Në piken 3 te ketij vendimi parashikohet dhe procedura qe ndiqet per regjistrimin e biznesit dhe çregjistrimin e kases fiskale dhe konkretisht 3.1 Në rastin e përfundimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore dhe shërbimin e mirëmbajtjes së loqërisë së autorizuar, brenda tri ditëve nga dita e përfundimit të kësaj primtarie.

Tekniku i autorizuar kryen procedurën e çregjistrimit me pajisje të hapur.

Të gjitha të dhënat e memories fiskale që dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit GPRS janë si më poshtë vijon:

- a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;
- b) emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale;
- c) numri i identifikimit të pajisjes;
- d) data, ora dhe minuta e mbarimit të regjistrimit të xhiros;
- e) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);
- f) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);
- g) totali i memories fiskale;
- h) totali i shkallëve tatimore;
- i) numërtori i raporteve tatimore ditore;
- j) numërtori i kuponëve tatimore;
- k) numërtori i ndërhyrjeve teknike;
- l) numërtori i ndryshimeve të shkallës tatimore;
- m) numërtori i ndryshimeve të adresës;
- n) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën e çregjistrimit të pajisjes fiskale;
- o) firma elektronike.

Pas dërgimit të të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe ta bashkëngjijë kuponin e printuar këtij libri.

Nuk rezulton që nga pala paditese të jete kryer kjo procedure e kerkuar dhe per kete arsye pala e paditur DRT Berat me te drejte ka nxjerre njoftim vleresimi per detyrimet tatimore per shkeljen e nenit 122/1/g te ligjit 'Per procedurat tatimore ne RSH'.

Per kete arsye, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.2034/17 prot, date 13.10.2015 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat lene ne fuqi me vendimin nr.27715/3 prot, date 14.12.2015 te Drejtorise se Apelitit Tatimor Tirane eshte nje akt administrativ i vlefshem pasi ka dale ne zbatim te ligjit te posaçem 'Per procedurat tatimore ne RSH' dhe padia e paditeses duhet te rrezohet si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, 50.000(pesëdhjete mijë lekë), për rrjedhojë duke patur parasysh se e drejta e ankimit rregullohet me ligj në këtë rast gjen zbatim dhe duhet të mbahet parasysh edhe neni 45 i këtij ligji dhe per kete arsye ky vendim eshte i paankimueshem.

Ne zbatim te nenit 106 te K.Pr.Civile shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales paditese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "**Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative**", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

- 1-Rrëzimin e kërkesë padisë.
- 2-Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- 3-Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 18.02.2016

SEKRETARË

Edlira **SHEHU**
SHPENZIMET GJYQËSORE

ksa e rregjistrimit
oftime
TALI

GJYQTARE

Gentiana **XHELILI**

3.000 (tre mijë) lekë
480(katerqind e tetëdhjete) leke
3480(tre mijë e katerqind e tetëdhjete) leke.

